



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.08.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.08.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik BK - CONSTRUCTION SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve Sylejman Hadum Aga dhe Ismajl Qemajli “, Nr. i prokurimit- 632-24-4730-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-24-058-511, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik BK - CONSTRUCTION SH.P.K. e dt.19.08.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve Sylejman Hadum Aga dhe Ismajl Qemajli “, Nr. i prokurimit- 632-24-4730-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-24-058-511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 14.08.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **14.08.2024;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik BK - CONSTRUCTION SH.P.K. me dt.19.08.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugëve Sylejman

Hadum Aga dhe Ismajl Qemajli “ , Nr. i prokurimit- 632-24-4730-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-24-058-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 28.08.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë sepse ju si Operator Ekonomik nuk e keni prezentuar :

- një personel me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nga MPMS dhe për mbrojtje nga zjarri nga AME;
- gjysëmrimorkio për bartjen e automjeteve të rënda me peshë bartëse min 18 t (gjysëmrimorkio duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) dhe
- gjysëmrimorkio kompresir mbi 1000 kg (gjysëmrimorkio duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

